

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Prantuar		11.03	20 21
Nj Org.	Numër	Shtojca	Vlera
13-	111-	11346	



**REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA- DRENAS
DREJTORATI PËR SHËRBIME
PUBLIKE DHE EMERGJENCË
Dt. 11/03/2021**



Në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-179, për Transportin Rrugor ,nenit 15,paragrafi 2, nenit 8,paragrafi 2 i Rregullores për Transportin Rrugor, në territorin e Komunës së Drenasit me nr.06-7086, dhe Vendimit të Kuvendit për miratimin e linjave urbane-periferike në komunën e Drenasit nr. 12-031-14044, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë rishpallë:

KONKURS PLOTËSUES

Për linjat Urbano-Periferike të transportit të rregullt të udhëtarve me autobus të mirtatuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit, për të gjithë Operoret e licencuar nga Ministria e infrastrukturës, bazuar në ligjin për Transport Rrugor, për linjat në vendbanimet për të cilat kompanit nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit dhe për disa nuk kemi pasur të inetersuar në dy konkursët e shpallura me heret.

Komuna fton të gjithë Operoret e licencuar të transportit rrugorë të udhëtarve me autobus, të interesuar që të aplikojnë për linjat si në vijim:

LINJAT :

1. **Drenas-Shtrubullovë-Krajkovë-Llapushnik,**
2. **Drenas- Sankoc-Fushticë e Epërme,**
3. **Drenas-Likoshan,**
4. **Drenas-Poklek i vjetër- Vasilevë,**
5. **Drenas-Gjergjicë,**
6. **Drenas-Arllat-Bytyq,**
7. **Drenas- Terstenik (deri të lagja Franca)**

Kushtet për aplikim:

1. Kërkesën për aplikim
2. Liçencë për transport të udhëtarve me autobus , të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës ,
3. Rendin e udhëtimit ku perfshinë : Emrin e operatorit, relacionin, radhitjen e vend-ndaljeve dhe largësin e tyre nga pika fillestare në km , kohën e nisjes dhe kohën e arritjes në qdo stacion dhe vend-ndalje, ditët e operimit (peridha kohere në të cilembahet linja)
4. Vertetim më të cilin vërtetohet se nuk është iniciuar ndonjë procedurë e pezullimit apo revokimit,

5. Vërtetimi i lëshuar që vërteton se Operatori Ekonomik nuk ka borxhe të pashlyera të taksës komunale deri në vitin 2019.
6. Vërtetim (jo më të vjetër se 30 ditë nga ATK-ja për kontributet e paguara dëshmi Lista e pagesave për kompanitë, të vulosur nga ATK-ja, së paku në 6 muajt e fundit), kopjet e kontratës së punës, patent - shoferi-kopje
7. Dëshmi për kapacitetet përkatëse të autobusëve (kopjet e librezave të qarkullimit dhe **çertifikatave të autobusëve të noterizuar**)

Mënyra e Aplikimit:

Aplikacioni i plotësuar së bashku me dokumentacionin duhet të dorëzohet në zyrën pritëse-kati i parë , Dokumentacioni dorëzohet në dy kopje, në dy zarfa të mbyllura prej të cilave në njërin duhet të jetë origjinali ndërsa tjetra kopje,të shënuara (të mos hapet).

Komisioni do të zgjedhë Operatoret të cilet i plotësojnë kriteret e përcaktuara në shpallje publike.

Aplikacionet hapën në zyret e Komunës.

Aplikacionet e pa nënshkruara dhe të pavulosura nga Menaxheri i Operatorit të Transportit nuk do të shqyrtohen dhe do të konsiderohen si të anuluar.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e shpalljes, nga dt:11.03.2021 deri me 26.03.2021,ora16:00

Aplikacionet mirren në sportelet e zyrës pritëse.

Vërejtje:

Linjat:

Për Gjergjicë duhet të mbahet duke qarkulluar nga rruga kryesore dhe hynë deri tek shkolla e fshatit.

Për Arllat-Bytyqt duhet të mbahet duke qarkulluar nga rruga kryesore dhe hynë deri në Lagjen Bytyqi.

Për Poklek-Vasilevë , linja duhet të mbahet duke qarkulluar deri të lagja Bresila.

Nisja e fundit prej Drenasi duhet të jetë prej ores 18:45-19:15, vlenë për të gjitha linjat.



DIREKTORI I DREJTORISË
Mumrije Krapaj